



# Çfarë do të thotë për ju shpallja i huaj i padëshirueshëm?

Ju keni marrë një shpallje i padëshirueshëm nga zyra e imigracionit dhe naturalizimit(IND). Në vendimin që keni marrë tregon përse ju jeni shpallur i huaj i padëshirueshëm. Në këtë broshurë shpjegohet se çfarë është shpallja i padëshiruar dhe çfarë do të thotë kjo për ju.

1. Çfarë është një shpallje i padëshirueshëm?
2. Sa zgjatë shpallja i padëshirueshëm?
3. Çfarë do të thotë sinjalizimi në një sistem informacioni?
4. Kur do të hiqen të dhënat tuaja nga E&S ose SIS?
5. Çfarë ndodh nëse ju prap se prap do jeni në Holandë?
6. Çfarë mund të bëni nëse nuk pajtoheni me shpalljen i padëshirueshëm?
7. Kur mund të udhëtoni ju përsëri në Holandë?
8. Si të kërkonte shfuqizimin e shpalljes i padëshirueshëm?
9. Çfarë duhet ju të bëni nëse keni pyetje?

## 1. Çfarë është një shpallje i padëshirueshëm?

Një shpallje i padëshirueshëm thotë se ju jeni i padëshiruar në Holandë. Ju do të merrni një shpallje i padëshirueshëm nëse IND vendos që ju jeni një rrezik për Holandën. Është një masë ndaj personave që zakonisht kanë kryer një vepër të rëndë penale. Shpesh bëhet fjalë për një krim. Ju duhet të largoheni menjëherë nga Holanda për shkak të shpalljes si i padëshirueshëm. Pas kësaj ju nuk mund të hyni më në Holandë. Ju do të sinjalizoheni për shpalljen i padëshirueshëm në një sistem informacioni. Lexoni në pyetjen 3 se çfarë është sinjalizimi.

## 2. Sa zgjatë shpallja i padëshirueshëm?

Shpallja e padëshirueshëm nuk ka datë përfundimi dhe përfundon vetëm atëherë kur IND vendos ta bëjë këtë. Kjo është e mundur nëse ju kërkonte shfuqizimin e shpalljes i padëshirueshëm. Pyetja 8 shpjegon se si të kërkohe shfuqizimi.

## 3. Çfarë do të thotë sinjalizimi në një sistem informacioni

Ju do të sinjalizoheni për shpalljen i padëshirueshëm. Të jesh i sinjalizuar ose sinjalizimi do të thotë që autoritetet e vendosin emrin tuaj në sistemin e informacionit. Autoritetet e shtetit shohin përmes sinjalizimit tuaj se ju jeni një i huaj i padëshirueshëm. Në vendim tregohet se në cilin sistem do të sinjalizoheni. Ka dy sisteme:

- Executie & Signalering (E&S)  
Ky është një sistem informacioni i policisë Holandeze dhe policisë ushtarake Mbretërore. Vetëm policia dhe policia ushtarake mund të kontrollojnë E&S.
- Sistemi i informacionit Shengen (SIS)  
Rojet kufitare dhe policia e shteteve të Shengenit mund të kontrollojnë SIS. Pas kontrolës ata mund t'ju ndalojnë: Nuk do të lejoheni të hyni në shtet. Ju mund të lexoni se cilat shtete (vende) janë shtete (vende) Shengen në [www.ind.nl/schengengebied](http://www.ind.nl/schengengebied) ose [www.ind.nl/schengenarea](http://www.ind.nl/schengenarea).

## 4. Kur do të hiqen të dhënat tuaja nga E&S ose SIS?

Nëse keni kërkuar që të shfuqizohet shpallja i padëshirueshëm dhe kjo kërkesë u është miratuar.

## 5. Çfarë ndodh nëse ju jeni prap se prap në Hoandë?

Qëndrimi në Holandë është i dënueshëm. Ju mund të merrni një dënim me burg deri në 6 muaj maksimalisht ose një gjobë prej disa mijra euro. Kjo ceket në nenin 197 të Kodit Penal.

## 6. Çfarë mund të bëni nëse nuk jeni i pajtimit me shpalljen i padëshirueshëm?

Ju mund të bëni një ankimim tek IND. Në vendimin që keni marrë tregohet se si mund ta bëni këtë.

## 7. Kur mund të udhëtoni ju përsëri në Holandë?

Nëse IND shfuqizon shpalljen tuaj si i padëshirueshëm. Kjo ndodhë vetëm nëse ju e kërkonit atë dhe nëse IND miraton kërkesën tuaj. Në situata shumë të veçanta dhe urgjente mund të kërkonit shfuqizimin e përkohshëm të shpalljes tuaj i padëshirueshëm.

## 8. Si të kërkonit shfuqizimin e shpalljes i padëshirueshëm?

Ju mund të kërkonit shfuqizimin e shpalljes i padëshirueshëm. Për këtë mund të përdorni formularin e *kërkesës për të shfuqizuar një shpallje i padëshirueshëm ose ndalimit të hyrjes* (9004 of 9504) në faqen e internetit për këtë qëllim, të plotësoni dhe ta dërgoni në IND. Ose ju mund të dërgoni një letër në IND. Shpjegoni IND-së pse dëshiron që IND të shfuqizoj (përkohësisht) shpalljen i padëshirueshëm. Dhe gjithashtu shkruani informacionin e mëposhtëm:

- Sa kohë keni qenë jashtë Holandës radhas (pa ndërprerje).
- Dhe a keni kryer krime të rënda gjatë asaj periudhe.
- Dhe a jeni në këtë moment duke u ndjekur penalisht për ndonjë vepër penale.

Gjithashtu dikush tjetër mund të kërkojë shfuqizimin në emrin tuaj. Ju duhet të i jepni atij personi lejen zyrtare për të ndërmarrë veprime në emrin tuaj. Ju e vendosni këtë në letër me nënshkrimin tuaj. Kjo quhet një autorizim. Bashkëngjit autorizimin me aplikikimin për shfuqizimin e shpalljes i padëshirueshëm.

Dërgoni formularin ose letrën tek:

IND Titel en Identiteit  
Postbus 10  
9560 AA Ter Apel

### *Situatat për shfuqizimin e shpalljes i padëshirueshëm*

IND mund të shfuqizoj (përkohësisht) shpalljen e padëshirueshëm në situatat e mëposhtme:

- Nëse është e domosdoshme që të vini në Holandë për shkak të situatave të rëndësishme në familjen tuaj.
- Nëse është e domosdoshme që të vini në Holandë për të dëshmuar në ndonjë çështje gjyqësore.
- Nëse është e domosdoshme që të vini në Holandë sepse ju keni një çështje tuajën gjyqësore.
- Shpallja i padëshirueshëm është në kundërshtim me konventën Evropiane për të drejtat e Njeriut (EVRM).
- Ju do të merrni një leje qëndrimi në Holandë pas një shpallje të mëparshme i padëshirueshëm.

### *Dokumentet për shfuqizimin e shpalljes i padëshirueshëm*

Dërgoni së bashku me formularin ose letrën edhe informacionet dhe dokumentet e mëposhtme:

- Një shpjegim se pse shfuqizimi i shpalljes i padëshirueshëm është i domosdoshëm në situatën tuaj.
- Të dhënat tuaja personale të plota dhe emrat e tjerë (pseudonimet) që keni përdorur më parë.
- Kopje të të gjitha faqeve të të gjitha pasaportave tuaja që keni pasur që nga shpallja i padëshirueshëm. Ose dokumente të tjera me të cilat mund të udhëtosh dhe të kalojnë kufirin.
- Një pasqyrë dhe dëshmi të shteteve dhe vendeve ku keni qenë pas shpalljes i padëshirueshëm. Me këtë tregoni se ju jeni jashtë Holandës gjatë aplikimit për shfuqizim. Ose që jeni kthyer në një shtet (vend) të BE/ZEE ku ju lejohet të jetoni. Lexoni në [www.ind.nl/eueer](http://www.ind.nl/eueer) dhe [www.ind.nl/en/eueea](http://www.ind.nl/en/eueea) cilat janë shtetet (vendet) e BE/ZEE.
- Dokumente zyrtare nga autoritetet e çdo shteti ku keni qenë pas shpalljes i padëshirueshëm. Kjo duhet të tregojë se ju nuk keni kryer ndonjë krim të rëndë në atë shtet. Dhe se ju aktualisht nuk ndiqeni penalisht për asnjë vepër penale në atë shtet.
- Nëse duhet të jeni përkohësisht në Holandë? Atëherë dërgoni gjithashtu edhe informacionin e mëposhtëm:
  - Datën e mbërritjes tuaj në Holandë dhe vendin ku do të hyni në Holandë.
  - Numrat e fluturimit, të fluturimit të ardhjes- dhe kthimit.
  - Një pasqyrë e të gjitha vendeve ku do të qëndroni në Holandë. Dhe dëshmi që ofrojnë siguri për qëndrimin tuaj dhe kostot e qëndrimit.
  - Në rast të një çështje penale: informacione për statusin dhe ecurinë e çështjes penale.
- Nëse ju autorizoni dikë tjetër që të kërkojë shfuqizimin në emrin tuaj: një autorizim me nënshkrimin tuaj.

Dokumentet zyrtare të huaja bëri të legalizuara dhe të përkthyer në Holandisht, Anglisht, Frëngjisht ose Gjermanisht. Lexoni informacione rreth legalizimit dhe përkthimit në [www.ind.nl/legalisatie-vertaling](http://www.ind.nl/legalisatie-vertaling) ose [www.ind.nl/legalisation-translation](http://www.ind.nl/legalisation-translation).

#### **9. Çfarë duhet të bëni nëse keni pyetje?**

- Vizitoni faqen tonë të internetit në [www.ind.nl/ongewenstverklaring](http://www.ind.nl/ongewenstverklaring) ose [www.ind.nl/en/undesirability](http://www.ind.nl/en/undesirability).
- Telefononi linjën e informacionit të IND në +31 88 043 04 30. Ky numër mund të arrihet nga e hëna deri të premtën nga ora 09.00 deri në ora 17.00.

*Asnjë e drejtë nuk mund të rrjedhë nga përmbajtja e publikimit. Nëse përkthimi çon në dallim në interpretim, versioni Holandez do të mbizotëroj. Teksti nga ky botim mund të përdoret me kusht që të përmendet burimi.*

